

Nr 6730/5 prot



01 16.11.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**
AKT-MIRATIMI
ORGAN I MIRATUAR
I VLERËSIM KONFORMITETIT.

Mbështetur në Kreun V të ligjit Nr. 10 489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, Urdhrit e Ministrit Nr. 53, datë 05.10.2017 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat e miratimit dhe mbikëqyrjes së organeve evropiane të notifikuara dhe organeve të miratuara të vlerësimit të konformitetit””, si edhe Certifikatës së Akreditimit me Numër Regjistrimi TI 017, datë 21.09.2020,

MIRATOJ:

Subjekti:	“NOA CONTROL” sh.p.k
Me Administrator:	Kledia STEFANI
Adresa e subjektit:	Rruga “Nikolla Tupe”, Ndërtesa Nr.3, Kati 1, Nr.1, Tiranë.
Tel.:	+355 42257444
Cel.:	+355 67 20 01 616
E-mail:	kledia.stefani@noacontrol.al

të ushtrojë veprimtarinë si «Organ i Miratuar i Vlerësimit të Konformitetit (OMVK)»:

Tipi i trupës së inspektimit:	Tipi A
Fusha e Veprimtarisë:	- Inspektim para vënies fillestare në punë dhe inspektim periodik; - Inspektimi i rezervuarëve të GLN- së më të vegjël ose të barabartë me 13 m³. - Inspektimi i rezervuarëve të GLN- së me kapacitet më të madh se 13 m³. - Inspektimi i pajisjeve nën presion (përfshihen rezervuarët e GLN-së dhe enët kriogjenike). - Inspektimi i kaldajave të avullit dhe ujit të nxehtë. - Inspektimi i enëve nën presion kriogjenike.

	- Inspektimi i rezervuarëve të hidrokarbureve të lëngëta. - Inspektimi i kokave të puseve. I. Inspektim para vënies fillestare në punë dhe inspektim periodik për: - Inspektimi i instalimeve elektrike në ambjente të zakonshme. - Inspektimi i impianteve elektrike në ambjente me rrezik zjarri. - Inspektimi i linjave të tensionit mbi 1000 Volt. - Inspektimi i impianteve të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike. - Inspektimi i impianteve shpërndarëse-nënstacionet. - Inspektimi i kabinave elektrike TM/TU. - Inspektimi i dispozitivit diferencial i vendosur në pajisjet, instalimet dhe impiantet elektrike. - Inspektimi i linjave kabllore. II. Pajisjet ngritëse: - Vinçat. a) Vinçat urë. b) Vinçat lëvizës dhe gjysëm lëvizës. c) Vinça të lëvizshëm dhe të palëvizshëm me krahë. d) Vinça të lëvizshëm dhe të palëvizshëm kullë ose me direk. e) Vinçat për servisimin e mjeteve. f) Vinçat për të ngritur njerëzit për të punuar në një platformë pune në lartësi. g) Vinçat – grajfer. - Pajisjet ngritëse të vinçave pirun. - Pajisjet ngritëse të transportuesit industrialë. III. Vlerësim i konformitetit të projekteve teknike dhe teknologjike për produktet/pajisjet/instalimet nën presion, sipas përcaktimit të pikës I. IV. Lëshim Vërtetimi Teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportit, tregtimit të gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre.
Rregullat teknike/standardet e sigurisë së produktit/pajisjes/instalimit të vënë në shërbim:	1. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1062, datë 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion”. 2. Standardi SSH EN 12817:2019 “Pajisjet e GLN dhe aksesoret. Inspektimi dhe rikualifikimi i rezervuarëve të gazit të lëngëzuar të naftës (GLN) me kapacitet më të vogël ose të barabartë me 13 m³”. 3. Standardi SSH EN 13175:2019 “Specifikimi dhe provat për ventilet dhe pajisjet e rezervuarëve të gazit të lëngëzuar të naftës (GLN)”.

4. Standardi SSH EN 12819:2009 “Pajisje dhe aksesoret për GLN. Inspektimi dhe rikualifikimi i rezervuarëve të gazit të lëngshëm të naftës (GLN) me kapacitet më të madh se 13 m³”.
5. Metodë jo-standarde: “Rregullore e sigurimit teknik për kaldajat e avullit dhe ujit të nxehtë”, viti 1988.
6. Metodë inspektimi jostandarde mbështetur në: Rregulloren “Për projektimin, prodhimin, vendosjen dhe shfrytëzimin e pajisjeve nën presion”, viti 1984.
7. Ligji Nr. 32/16, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”.
8. SH EN 21009-2:2015 “Enët nën presion kriogjenike. Enët statike të termoizoluara me vakum”.
9. SSH EN 14015:2004 “Specifikim për projektimin dhe prodhimin e rezervuarëve prej çeliku të salduar vertikale, cilindrike, me fund të sheshtë, mbi tokë, të ndërtuar në vend për depozitimin e lëgjeve në temperaturën e ambjentit e më lart”.
10. Urdhrit të Ministrit Nr. 184, datë 5.7.2005 “Kushtet teknike dhe normat e projektimit për impiantet dhe instalimet që shërbejnë për transportin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”.
11. VKM Nr. 245, datë 30.3.2016 “Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e dispozitivit diferencial, vendosur në pajisjet, impiantet dhe instalimet elektrike” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara.
12. Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike.
KTP 15-78 “Instalimet elektrike në ambjentet me rrezik zjarri”.
KTP 16-78 “Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike”.
13. Vendim Nr.482, datë 17.06.2020 “Për miratimin e rregullit teknik “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kv”.
14. Vendim Nr.483, datë 17.06.2020 “Për miratimin e rregullit teknik “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike me tension të lartë mbi 1 kv”.
15. Ligji Nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë në punë të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 13/2013.
16. VKM Nr. 1060, datë 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik “Për makineritë”.
17. VKM Nr. 430, datë 26.06.2019 “Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve të transportueshme nën presion”.

	18. Urdhri Nr. 3403/1 prot., datë 30.06.2003 “Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike”, miratuar nga Ministri i Industrisë dhe Energjitikës.
Periudha e vlefshmërisë:	Deri më 20.09.2024
Teritori i ushtrimit të veprimtarisë:	Në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Personi përgjegjës firmosës:	Kledia STEFANI
Nr. Telefoni:	+355 67 20 01 616
E-mail:	kledia.stefani@noacontrol.al
OMVK regjistrohet me Nr. Identifikimi:	OMI 0 1 3

“Organi i Miratuar” i vlerësimit të konformitetit detyrohet të plotësojë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij kërkesat dhe kushtet e veçanta si më poshtë:

1. Është përgjegjës për veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit, të kryera sipas objektit të tij të miratimit dhe çdo veprimtari tjetër të kryer, përfshirë veprimtaritë nënkontraktuese.
2. Nuk duhet të përfshihet në veprimtaritë që mund të krijojnë konflikt me pavarësinë/paanësinë e tij të gjykitimit ose integritetin për aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar;
3. Siguron se veprimtaritë e degëve ose nënkontraktorëve të tij nuk prekin/ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin, paanësinë e veprimtarive të tij të vlerësimit të konformitetit;
4. I siguron Ministrin, Strukturës Administrative Përgjegjëse (SAP), brenda 10 ditësh, kopje të certifikatave, raporteve të testeve dhe të vlerësimit të konformitetit, përfshirë dokumentet për to dhe informacionin për lëshimin, refuzimin ose tërheqjen e certifikatave për çdo subjekt;
5. Detyrohet të informojë Ministrin pa vonesë për çdo rast, në të cilin ky organ bëhet i paaftë të sigurojë përmbushjen e kushteve të vendosura për ushtrimin e miratimit të vlefshmërisë së konformitetit;
6. Informon brenda 5 ditësh Ministrin (SAP) për çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje certifikate;
7. Informon Ministrin për çdo kërkesë për informacion, të cilën ai ka marrë nga Inspektorati Shtetëror në vartësi të MIE-s për veprimtarinë e vlerësimit të konformitetit;
8. Detyrohet të mbajë regjistra të plotësuar rregullisht të të gjitha procedurave të vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar dhe të rezultateve të tyre për jo me pak se 10 vjet.
9. Me kërkesë të ministrit përgjegjës detyrohet të marrë pjesë në testime ose krahasime të tjera të përcaktuara për OMVK-të.
10. Në fund të çdo periudhe katërmujore, detyrohet ti dërgojë Ministrin (SAP) regjistrin e inspektimeve ose certifikatave të lëshuara për periudhën në fjalë.
11. Organi i Miratuar detyrohet t’u krijojë akses të plotë punonjësve të SAP, të pajisur me urdhër të Ministrin, që të evidentojnë të gjitha të dhënat për përmbushjen e kërkesave të vlerësimit të konformitetit dhe të hyjnë në të gjitha ambientet ku OMVK ka kryer vlerësimi të konformitetit, të përcaktuar në miratimin e lëshuar.

Në rast të konstatimit të mos plotësimit të kërkesave dhe kushteve sipas pikave 2,3,4,5,6,8,9,10,11, ose në rast se organi i miratuar nuk arrin të përmbushë më, një apo disa kriteret a kërkesa të përcaktuara në rregullat teknike përkatëse apo në rregullat për sigurinë e produktit/instalimit të vendosur në shërbim/në përdorim dhe kushtet e përcaktuara në vendimin e miratimit, Struktura Administrative Përgjegjëse i propozon Ministrin pezullimin e Autorizimit deri në afatin e dhënë për plotësimin e tyre.

Nëse Organi i Miratuar dështon në plotësimin e kushteve dhe kërkesave sa më sipër brenda afatit të caktuar, Struktura Administrative Përgjegjëse përgatit dhe i paraqet për firmë Ministrit urdhërin për anulimin e Aktit të Miratimit dhe heqjen e emrit të OMVK-së nga regjistri i organeve të miratuara.

Datë: 16 / 11 / 2020

Ministri

BELINDA BALLUKU

